

VENDIM
Nr. 74, datë 12.12.2016

**AUTORIZIM I NDIHMËS SHETETËRORE NËPËRMJET MBËSHKETJES FINANCIARE
TË PROJEKTEVE NË SEKTORIN E TURIZMIT**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------------|-----------|
| - Znj. Milva Ekonomi | kryetare; |
| - Znj. Mimoza Dhëmbi | anëtare; |
| - Z. Ahmet Maqcellari | anëtar; |
| - Z. Petrit Bakiu | anëtar; |
| - Z. Gramoz Hoxha | anëtar. |

Në mbledhjen e tij të datës 12/12/2016, shqyrtoi “ex-post” masën e sipërpërmendur, të hartuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) dhe vendosi të konsiderojë ndihmën në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

I. PROCEDURA

1. Në zbatim të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, neni 28/1, Sektori i Kontrollit të Ndhmës Shtetërore, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) grumbulloi dhe përpunoi të dhënat për mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit të projekteve në fushën e turizmit, në përputhje me rregullat e ndihmës shtetërore. Më pas këto të dhëna iu propozuan Komisionit të Ndhmës Shtetërore për vlerësim dhe autorizimin “ex-post” të skemës së ndihmës shtetërore.

II. PËRSHKRIMI I MASËS

a) Objektivi i masës së ndihmës

2. Qëllimi i ndihmës është mbështetja me fonde publike të projekteve të studimit, promovimit dhe edukimit apo modele inovative të produkteve turistike, në funksion të zhvillimit të turizmit.

b) Baza ligjore

3. Baza ligjore është vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.4.2016, “Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”.

c) Dhënësi i ndihmës

4. Dhënës i ndihmës është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS). Zbatues i skemës është Drejtoria e Përgjithshme e Turizmit në MZHETTS.

ç) Instrumenti i ndihmës

5. Ndihma do të jepet në formën e financimit nga buxheti i shtetit. Fondet parashikohen dhe miratohen çdo vit në programin “Zhvillimi i Turizmit”, që administrohet dhe menaxhohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Për vitin 2017 janë parashikuar 42 mln lekë nga buxheti i shtetit për mbështetjen e subjekteve që do të ushtrojnë veprimtari ekonomike në fushën e zhvillimit të turizmit. Ndihma nuk mund të jepet më tepër se një herë në vit për të njëjtin subjekt konkurrues.

d) Intensiteti i ndihmës

6. Vlera gjithsej e parashikuar për mbështetjen e ndërmarrjeve në fushën e turizmit do të financohen nga buxheti i shtetit. Për realizimin e projekteve konkurruese turistike, skema e financimit do të mbulojë deri në 50% të kostove të pranuar e të miratuara nga ministria përgjegjëse për turizmin. Për projektet, për të cilat kërkohet një financim që kalon 50% të fondit buxhetor vjetor të parashikuar në buxhetin e shtetit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

e) Përfituesit e ndihmës

7. Përfituesit janë subjektet që operojnë në fushën e zhvillimit të produkteve turistike.

ë) Aktivitet të cilat përfitojnë ndihmën shtetërore

9. Një subjekt do të përfitojë ndihmë shtetërore nëse do të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) nuk janë në proces falimentimi dhe se kapitalet e tij nuk janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;

b) nuk janë subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe nuk ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose nuk ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;

c) nuk janë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale si person juridik, ortak apo aksionar i shoqërisë;

d) kanë përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

e) kanë përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.

III. VLERËSIMI I NDIHMËS SHTETË-RORE

a) Ndihmë shtetërore e drejtpërdrejtë për ndërmarrjet

10. Ligji nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, parashikon se: “Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojnë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

11. Gjithashtu, në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, neni 71, ndalohet çdo ndihmë shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të kërcënojë të shtrembërojnë konkurrencën duke favorizuar sipërmarrje të caktuara ose produkte të caktuara, dhe nuk është e pajtueshme me funksionimin e duhur të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, në masën që mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.

12. Së pari, duhet vlerësuar nëse skema shtrembëron apo kërcënon të shtrembërojnë konkurrencën. Skema jep një avantazh subjekteve përfituese sikurse përshkruhet në paragrafin nr. 9. Ky avantazh jepet nga burime shtetërore dhe favorizon vetëm ndërmarrjet që operojnë në fushën e turizmit. Mbështetur në faktin e thjeshtë se pozita konkurruese e një ndërmarrjeje forcohet në krahasim me ndërmarrjet e tjera, duke i dhënë asaj një përfitim ekonomik të cilin nuk do ta kishte marrë përgjatë ushtrimit normal të aktivitetit të saj ekonomik, atëherë krijohet një efekt i kufizimit të konkurrencës në treg.

13. Së dyti, duhet vlerësuar nëse efekti i kufizimit të konkurrencës shtrihet dhe mund të ndikojnë deri në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë. Ndihma ka efekt në tregti mes Komunitetit dhe Shqipërisë. Përfituesit e ndihmës ushtrojnë aktivitet ekonomik në një treg që ofron shërbime në fushën e turizmit brenda dhe jashtë vendit. Sektori është i hapur për konkurrencën në nivel evropian dhe si pasojë ndikohet ndjeshëm ndaj çdo mase e cila mbështet prodhimin/shërbimin në një ose disa shtete anëtare.

Komisioni arrin në përfundimin se masa, në interpretimin që u bëhet akteve dhe fakteve të sipërpërmendura, është ndihmë shtetërore.

b) Përputhshmëria e skemës së ndihmës shtetërore

14. Ligji nr. 9374, datë 21.5.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, neni 8, ndihma “De minimis”, parashikon se ndihma është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

15. Në bazë të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016, pika II, shkronja “a” Ndihma “de minimis” lejohet nëse nuk e kalon vlerën e përgjithshme 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh për një ndërmarrje të vetme.

16. Projektet që do të marrin ndihmë do të synojnë:

- përgatitjen e studimeve apo të modeleve të produkteve turistike;
- promovimin e destinacioneve turistike e të vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të vendit;
- edukimin profesional të burimeve njerëzore të subjekteve që zhvillojnë veprimtari në fushën e turizmit me qëllim rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e shërbimit.

17. Në ligjin nr. 93/2015, “Për turizmin”, neni 31, pika 4, përcaktohet se fondet për mbështetjen financiare për projektet në fushën e turizmit nuk i nënshtrohen legjislacionit të prokurimit publik. Dhënësi i ndihmës duhet të sigurojë mirëpërdorimin e fondeve publike, të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë në fushën e turizmit dhe të trajtojë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese operatorët gjatë pjesëmarrjes në procesin e shqyrtimit të aplikimeve. Për këtë arsye, Komisioni vlerëson se është e nevojshme të rishikohet përmbajtja e njoftimit publik ku ftohen të marrin pjesë të gjithë të interesuarit për projekte në fushën e turizmit dhe se qartazi duhen përcaktuar

edhe disa elementë shtesë, si p.sh., renditja e të gjithë përfituesve potencialë (ente publike/ndërmarrje) nga skema e ndihmës, kategorinë e aktiviteteve të cilat kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë, vlerën maksimale dhe minimale të mbështetjes me ndihmë shtetërore duke parashikuar në mënyrë të përafërt edhe numrin gjithsej të përfituesve të skemës, si edhe të listojë kostot e pranueshme për të cilat jepet ndihmë shtetërore.

18. Komisioni vlerëson se skema është hartuar për të nxitur zhvillimin ekonomik të rajonit në fushën e turizmit. Autoriteti zbatues i skemës do të raportojë të dhëna mbi baza vjetore lidhur me impaktin ekonomik të skemës në punësim, zhvillimin ekonomik etj. Gjithashtu, aplikimet për ndihmë do të merren përpara fillimit të zbatimit të projektit. Përfituesi duhet të ofrojë një kontribut minimal prej 50% të kostove të pranuar e të miratuara nga dhënësi i ndihmës. Ndihma në këtë skemë nuk do të jepet për ndërmarrjet në vështirësi.

Sa më lart, skema përmbushë kriteret për t'u konsideruar e lejueshme në bazë të nenit 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 13, 17, shkronja "ç", 22, pika 2/1, 30 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë ndihmën shtetërore nëpërmjet mbështetjes financiare të projekteve në sektorin e turizmit, të parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.4.2016, "Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit", mbështetur në nenin 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar.

2. Dhënësi i ndihmës në njoftimin publik, ndër të tjera, duhet të përcaktojë edhe:

- përfituesit potencialë (ente publike/ ndërmarrje) nga skema e ndihmës;
- kategorinë e aktiviteteve të cilat kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë;
- vlerën minimale dhe maksimale të mbështetjes me ndihmë shtetërore; si edhe të,
- listojë kostot e pranueshme për të cilat jepet ndihmë shtetërore;

3. Në zbatim të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016, dhënësi i ndihmës gjatë vlerësimit dhe miratimit të ndihmës për një ndërmarrjeje të vetme duhet të ketë parasysh dhe të informojë përfituesin e ndihmës se ndihma e marrë nuk do ta kalojë vlerën e përgjithshme prej 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekësh, për një periudhë financiare prej tre vjetësh për një ndërmarrje të vetme. Në rast të kundërt, ndihma konsiderohet e paligjshme.

4. Dhënësi i ndihmës, me qëllim rritjen e efikasitetit të ndihmës shtetërore, duhet të hartojë dhe të publikojë një mekanizëm që të përmbajë edhe indikatorë për matjen e performancës dhe impaktin e turizmit, si edhe të ofrojë oportuniteteve ekonomike. Ky mekanizëm është i domosdoshëm për monitorimin dhe kontrollin e skemës ku duhet të jenë përfshirë elementet e mëposhtme:

- Përshkrimi i detajuar i kostove të pranueshme;
- Dorëzimi i raporteve financiare;
- Monitorimi i ndihmës së dhënë, sidomos me qëllim përmbushjen e objektivave për të cilët u miratua, si edhe përmbushja e termave të kontratës;
- Njohja e shpenzimeve vetëm kundrejt faturave;
- Kthimi i ndihmës në rast shkelje.

5. Çdo përfitues ndihme duhet të nënshkruajë deklaratën e ndihmës "De Minimis" (bashkëlidhur) dhe të dorëzojë një kopje të deklaratës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Turizmit dhe një kopje pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

6. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), në cilësinë e dhënësit të ndihmës, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

7. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit

individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

8. MZHE'TS-ja, bazuar në nenin 20, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-së në rastin eventual të çdo ndryshimi të skemës së njoftuar.

9. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Milva Ekonomi

